

SHOQERIA "BIG BULQIZA" SHPK  
NIPT M06730401U

Adresa: Lagjja Minatori, Rruga e Pazarit, Objekt Privat tre katesh, kati i pare me Nr Pasurie  
2148/3, Zona Kadastrale 8612, tel 0694011888, Bulqize.  
E-mail [bigbulqiza@gmail.com](mailto:bigbulqiza@gmail.com)

## VENDIM

NR. 04, DATE 19 . 04 . 2021

### I

## ASAMBLESE SE ZAKONSHME TE SHOQERISE "BIG BULQIZA" SHPK

Asambleja e zakonshme e shoqerise "Big Bulqiza" shpk, e mbledhur sot, me date 19 . 04 . 2021, në adresën e ortakut Bigalb Group: Vaqarr, Gropaj Tiranë me pjesmarjen e ortakeve: **Znj. Elona Koshi**, me cilesine e "Personit te Besuar" **Z. Vullnet Sinaj**, ortak i vetem i shoqerise "BIGALB GROUP" sh.p.k. dhe **Z. Arlind Çela**, me qëllim përmirësimin e administrimit të shoqërisë, bazuar në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar,

## VENDOSI

1. Pas nenit 9 të Statutit të shoqërisë të shtohet Neni 9/1 me këtë përmbajtje:

Neni 9/1

- 9.1.1** Ortaku "Bigalb Group" sh.p.k ka të drejtë vote të barabartë me një kuotë prej 51% të Kapitalit të rregjistruar të shoqërisë dhe ka të drejtë të plotë vendimarrje sipas kuotës së përcaktuar 51%, por në këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë është vendosur që: **Ortaku "Bigalb Group" sh.p.k, vetëm për sa i përket fitimit, do të përfitojë 50% të fitimit të deklaruar nga shoqëria në pasqyrat financiare.**
- 9.1.2** Ortaku **Arlind Cela** ka të drejtë vote të barabartë me një kuotë prej 49% të Kapitalit të rregjistruar të shoqërisë dhe ka të drejtë të plotë vendimarrje sipas kuotës së përcaktuar 49%, por në këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë është vendosur që: **Ortaku Arlind Cela, vetëm për sa i përket fitimit, do të përfitojë 50% të fitimit të deklaruar nga shoqëria në pasqyrat financiare.**
- 9.1.3** Të drejtat e përfitimit të dividendit, sa më sipër, nuk janë të transferueshme tek të tretët pa pëlqimin e të gjithë ortakëve të shoqërisë.


Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E SHOQERIS BIG BULQIZA SHPK ORTAKET

**BIGALB GROUP sh.p.k**  
**Elona KOSHI**



**ARLIND ÇELA**



SHOQERIA "BIG BULQIZA" SHPK  
NIPT M06730401U

Adresa: Lagjja Minatori, Rruga e Pazarit, Objekt Privat tre katesh, kati i pare me Nr Pasurie  
2148/3, Zona Kadastrale 8612, tel 0694011888, Bulqize.  
E-mail [bigbulqiza@gmail.com](mailto:bigbulqiza@gmail.com)

## VENDIM

NR. 03, DATE 19 . 04. 2021

I

### ASAMBLESE SE ZAKONSHME TE SHOQERISE "BIG BULQIZA" SHPK

Asambleja e zakonshme e shoqerise "Big Bulqiza" shpk, e mbledhur sot, me date 19 . 04. 2021, në adresën e ortakut Bigalb Group: Vaqarr, Gropaj Tiranë me pjesmarjen e ortakëve: **Znj. Elona Koshi, me cilesine e "Personit te Besuar" Z. Vullnet Sinaj, ortak i vetem i shoqerise "BIGALB GROUP" sh.p.k. dhe Z. Arlind Çela,** në lidhje me zbatimin e nenit 70 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 28 te ligjit nr.9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit;


### VENDOSI:

1. Shoqëria nuk do të kryejë asnjë veprimtari fitiprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të ketyre, me qëllim zbatimin me korektesi të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë dhe kompetencë për të nënshkruar kontrata apo çdo lloji marëveshje që, në një mënyrë apo tjetër, ka lidhje me veprimtari fitiprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të ketyre.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administratori i shoqërisë
4. Te depozitohet ky vendim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR)


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E SHOQERIS BIG BULQIZA SHPK ORTAKET

**BIGALB GROUP sh.p.k**  
**Vullnet SINAJ**  
**Person i besuar nga ortaku**  
**Elona KOSHI**

  
Elona Koshi

**ARLIND ÇELA**

  
Arlind Çela